REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 331 datë 9.7.1993

PËR

**MIRATIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR BASHKË-PUNIMIN E ADMINISTRATAVE DOGANORE"**

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për bashkë-punimin e administratave doganore", e cila u nënshkrua në Athinë më 17 maj 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ALEKSANDËR MEKSI

Nr.prot.1866/1

Datë 13.7.1993

PRESIDENCËS
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË KASACIONIT
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE E TË EKONOMISË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VULLNET ADEMI

# MARREVESHJE

## MIDIS QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

## DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE GREQISE

## PER BASHKEPUNIMIN E ADMINISTRATAVE

## TE TYRE DOGANORE

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Greqise,

Duke njohur se shkeljet e ligjeve dhe rregullave doganore demtojne interesat ekonomike, tatimore, sociale dhe interesa te tjera te vendeve te tyre;

Duke konsideruar te rendesishme per llogaritjen e sakte te taksave Doganore, tatimeve dhe detyrimeve te tjera qe merren gjate import-eksportit te mallrave dhe sendeve te tjera, si dhe duke zbatuar me korrektesi ndalimet, kufizimet dhe kontrollet;

Te bindura qe bashkepunimi midis Administratave te tyre Doganore, ne vecanti duke marre parasysh ekzistencen e kufijve te perbashket te dy vendeve te tyre, do te kontribuoje ne nje veprimtari me efektive per parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore, duke perfshire trafikun e transportimin e paligjshem neper kufi te armeve, te lendeve plasese dhe municioneve si dhe gjithashtu te objekteve me vlera kulturore dhe trafikun e jashteligjshem te narkotikeve dhe te substancave psikotrope;

Rane dakord si me poshte;

### NENI 1
### Per qellimet e kesaj marreveshjeje;

a) Me "Ligje dhe Rregulla Doganore", kuptojne teresine e dispozitave juridike dhe rregulluese te cilat zbatohen nga Doganat dhe qe rregullojne menyrat e importit, eksportit dhe tranzitimit te mallrave, levizjen e personave dhe te mjeteve te tjera te transportit, vjeljen e detyrimeve Doganore, taksave dhe det-

vrimeve te tjera, si dhe dispozita te tjera qe kane te bejne me probleme doganore;

b) "Administrata Doganore"

- Ne Republiken e Shqiperise eshte Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne Ministrine e Financave dhe te Ekonomise te Republikes se Shqiperise;

- Ne Republiken e Greqise eshte Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne Ministrine e Financave te Republikes se Greqise.

c) "Shkelje Doganore", kuptojme çdo shkelje apo tentative shkelje te Legjislacionit Doganor;

d) "Person", kuptojme çdo person fizik apo juridik;

e) "Objekte me vlere kulturore", kuptojme sende me karakter kulturor, fetar apo dekorativ dhe qe konsiderohen te rendesishme per shkak te vleres se tyre arkeologjike, prehistorike, historike, letrare dhe shkencore.

NENI 2

Bashkepunim ne shkollim

1. Palet i japin njera tjetres, brenda mundesive te tyre, çdo lloj ndihme per probleme te shkollimit profesional te personelit te Administratave te tyre Doganore.

P e r k e t e q e l l i m;

- mund te pranojne, ne institucionet e tyre shkolluese ose ne Zyrat Doganore, personel te Administrates Doganore te Pales tjeter per shkollim dhe stervitje praktike.

- sipas kerkeses se njeres Pale, Pala tjeter mund te dergoje tek ajo personel per te marre pjese ne seminare ose ngjarje te tjera, qe ka si qellim permiresimin e aftesive te tyre profesionale.

2. Palet do te çojne perpara bashkepunimin teknik me qellim;

- shkollimin e personelit te tyre per te fituar pervoje te kualifikuar;

- shkembimin e njohurive dhe te pervojes lidhur me perdorimin e metodave dhe te mjeteve per parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore;

- shkembimin e eksperteve qe kane nje fare pervoje dhe

njohuri speciale ne hetimmin dhe ndalimin e shkeljeve doganore;

– shkembimin e informacionit profesional, shkencor e teknik lidhur me rregullat e procedurat Doganore;

– vendosjen e çfaredo forme tjeter bashkepunimi teknik, te cilen Palet mund ta konsiderojne si te pershtateshme.

NENI 3

Qellimi i ndihmes reciproke

1. Me anen e kesaj Marreveshjeje, Palet vendosin bashkepunim dhe nje ndihme reciproke midis Administratave te tyre Doganore.

Cdo ndihme qe parashikohet nga kjo Marreveshje, jepet nga njera ose tjetra Pale duke respektuar Legjislacionin e tyre Kombetar.

2. Ne kuadrin e kompetencave te veta, Administrata Doganore e njeres Pale nen kushtet e kesaj Marreveshjeje do t'i jape Administrates Doganore te Pales tjeter, ndihme ne parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve dogannore.

3. Administratat Doganore te Paleve do te japin reciprokisht te gjithe informacionin e mundeshem qe siguron perllogaritjen e sakte te detyrimeve Doganore, taksave dhe detyrimeve te tjera gjate importit dhe eksportit.

NENI 4

Dorezime te kontrolluara

1. Ne baze te Legjislacionit te tyre Kombetar, Administratat Doganore te Paleve mund te bien dakord per te zbatuar metoden e dorezimit te kontrolluar te narkotikeve dhe substancave psikotrope, me qellim zbulimin e personave qe jane perfshire ne kete trafik te jashteligjshem.

2. Dorezimet e kontrolluara mund te kene formen ose te lenies se ngarkeses se paprekur ose duke e konfiskuar ngarkesen ne nje faze ndermjetese ose duke e levizur dhe zevendesuar ngarkesen pjeserisht.

3. Palet do te rregullojne midis tyre formen dhe menyrat per zbatimin ne çdo rast te metodes se dorezimit te kontrolluar, si dhe problemet e rregullimeve financiare.

4. Rezultatet e dorezimit te kontrolluar do te komunikohen reciprokisht sa me shpejt te jete e mundur.

## NENI 5

### Ruajtja e sekretit

1. Informatat, dokumentat dhe te dhenat te tjera te perfituara ne kuadrin e ndihmes reciproke, mund te perdoren nga Pala Marrese vetem per qellimet e percaktuara ne kete Marreveshje dhe vetem nga organet kompetente , duke perfshire perdorimin e tyre gjate procedurave gjyqesore apo administrative.

Kete lloj informatash, dokumentash dhe te dhena te tjera mund te perdoren per qellime te tjera (ose komunikim te metejshem nga Pala Marrese per Pale te Treta) vetem kur pala furnizuese shpreh qarte pelqimin e saj perkates

2. Sipas kerkeses se pales furnizuese, informatat, dokumentat dhe te dhenat e tjera te furnizuara ne baze te kesaj Marreveshjeje, do te konsiderohen si sekret nga Pala Marrese.

3. Informatat, dokumentat dhe te dhenat e tjera te furnizuara ne baze te kesaj Marreveshje do te konsiderohen te Pala Marrese ne te njejten shkalle te sekretit zyrtar qe ajo Pale zbaton lidhur me informatat, dokumentat dhe te dhenat e tjera te mbledhura ne territorin e saj.

## NENI 6

### Perjashtime te ndihmes reciproke

Ne rastet kur Pala, tek e cila eshte adresuar kerkesa per ndihme, konsideron qe plotesimi i kerkeses mund te demtoje sovranitetin e saj, sigurine, rendin shoqeror ose sektore te tjere te rendesishem te interesave te saj Kombetare, ajo mund te refuzoje te jape ndihme ose te kondicionoje plotesimin e kerkeses me respektimin e disa kushteve.

## NENI 7

### Forma dhe permbajtja e kerkesave per ndihme

1. Kerkesat per ndihme qe behen ne baze te kesaj Marreveshjeje duhet te paraqiten me shkrim. Ne qofte se kerkesa eshte e natyres urgjente, eshte e mundur qe ajo te pranohet dhe gojarisht, por nje konfirmim i shkruar duhet te paraqitet me vone.

Dokumentat e kerkuara per plotesimin e saj duhet te jene bashkengjitur kerkeses.

2. Kerkesa do te perfshije:
   - autoritetin qe ben kerkesen;
   - llojin e procedures(juridike,administrative etj)
   - qellimin dhe aresyet e kerkeses;
   - pershkrim i shkurter i thelbit te ceshtjes dhe te karakterit te saj ligjor;
   - emrat dhe adresat e njerezve qe kane lidhje me procedurat, nese njihen.

NENI 8

**Kanalet e komunikimit**

1. Funksionimi i ndihmes reciproke realizohet nepermjet komunikimit te drejteperdrejte midis funksionareve te caktuar prej Kryetareve te Administratave respektive Doganore te Paleve .

2. Ne rastin kur Sherbimi Doganor, i Pales se ciles i eshte drejtuar kerkesa, nuk eshte kompetent per t'ju pergjigjur kerkeses, ai ia kalon kerkesen Autoriteteve kompetente.

NENI 9

**Plotesimi i kerkeses**

1. Administrata Doganore, tek e cila drejtohet kerkesa, ben perpjekjet e duhura per plotesimin e saj.

2. Administrata Doganore e njeres Pale, mundet, ne vijim te kerkeses se shprehur nga Administrata Doganore e Pales tjeter ,te beje hetimin e domosdoshem ose te grumbulloje informacione per te cilat eshte kompetente te grumbulloje, duke perfshire edhe marrjen ne pyetje te eksperteve, te deshmitareve dhe personave qe dyshohen per shkelje doganore.

3.Administrata Doganore e njeres Pale, mundet, ne vijim te kerkeses se shprehur Administrata Doganore e Pales tjeter, te beje verifikime, kontrolle dhe hetime me qellim qe te konstatoje fakte lidhur me rastet per te cilat Administrata Doganore e kerkuar eshte kompetente dhe keto perfshihen ne kete Marreveshje.

4. Lidhur me kerkesen, Pala se ciles i eshte drejtuar kerkesa, mund te autorizoje funksionaret e Pales kerkuese te vijne ne territorin e saj dhe te japin informacion ose ndihme ne lidhje me rastin ne shqyrtim.(Keta persona gezojne ne territorin e Pales tjeter mbrojtjen e garantuar, siguruar nga ligjet kombetare dhe rregulloret per funksionaret e Pales Pritese dhe i jane pershtatur asaj lidhur me pasojat penale te shkeljeve qe jane bere ndaj ose prej tyre).

5. Kerkesa e nje Pale ,qe te ndiqen disa procedura, do te duhet te plotesohet ne perputhje me Legjislacionin e Pales se ciles i eshte drejtuar kerkesa.

Pala kerkuese do te informohet si per kohen dhe vendin e hyrjes se veprimit, ne perputhje me kerkesen e saj, per te siguruar koordinimin e veprimit .

Ne rastin kur kerkesa nuk mund te plotesohet, Pala kerkuese do te informohet per kete si dhe per arsyet e mosplotesimit.

6. Plotesimi i kerkeses per ndihme [illegible] ne baze te ketij neni, do te realizohet [illegible] me ligjet dhe rregulloret e Pales se ciles i eshte drejtuar kerkesa.

NENI 10
Dosjet dhe dokumentat

1. Origjinalet e dosjeve, dokumentave dhe te dhenave te tjera, ne masen qe ato te mund te behen te vlefshme nga Administrata Doganore nga e cila ato jane kerkuar , mund te jipen ne rastet kur kopjet nuk jane te mjaftueshme per qellimin.

Pas nje kerkese te veçante kopjet e skedareve te tille origjinale, te dokumentave dhe te te dhenave te tjera legalizohen.

Dosjet origjinale,dokumentat dhe te dhenat e tjera qe jipen, [illegible] ne rastin me te pare.

2.Gjate zbatimit te ketij Neni nuk duhet te preken te drejtat e Pales se ciles i drejtohet kerkesa ose Paleve te Treta qe kane lidhje me raste te veçanta.

NENI 11
Deshmitare dhe eksperte

1. Administrata Doganore e njeres Pale mundet te autorizoje funksionaret e saj, sipas kerkeses se Administrates Doganore te Pales tjeter,qe te paraqiten si deshmitare ose eksperte ne procese gjyqesore apo administrative ne territorin e Pales tjeter, si dhe te jape dosjet, dokumentat ose te dhena te tjera ose kopjet e legalizuara kur keto provohen se jane te domosdoshme per proceduren.

2. Sipas kushteve te kesaj Marreveshjeje, kur funksionaret e nje Pale gjenden ne territorin e Pales tjeter, duhet te kene mundesine te paraqesin vertetime me shkrim mbi kompetencat e tyre zyrtare.

Njekohesisht nuk duhet te jene me uniforme e me arme.

NENI 13

Shpenzimet

1. Palet heqin dore nga kerkimi i rimbursimeve per shpenzi-
met qe ata bejne gjate zbatimit te kesaj Marreveshjeje, me per-
jashtim te shpenzimeve per deshmitaret dhe ekspertet (Neni 11) si
dhe te shpenzimeve qe kane te bejne me dorezimin e kontrolluar te
mallrave (neni 4).

2. Shpenzimet per levizjen dhe qendrimin e deshmitareve dhe
eksperteve do te mbulohen nga Pala kerkuese.

NENI 13

Raste te veçanta te bashkepunimit

1. Pasi bejne kerkese Administratat Doganore te Paleve, do
te informojne njera tjetren ne lidhje me faktin ne se mallra apo
sende te tjera te eksportuar nga territori i nje Pale u importuan
sipas ligjit ne territorin e Pales tjeter.

Nje informacion i tille duhet te shoqerohet, me sa te jete e
mundur, me dokumentat Doganore qe jane perdorur per doganimin.

2. Administrata Doganore e nje Pale, me kerkesen e
Administrates Doganore te Pales tjeter, brenda mundesive te saj
mund te ushtroje kontroll veçanerisht mbi:

- mjetet e transportit per te cilat dyshohet per shke-
lje te Legjislacionit Doganor ne territorin e Pales
kerkuese;
- mallrat dhe sendet e tjera te cilat Pala kerkuese
i konsideron si objekte te tregtise se paligjshme dhe
qe destinohen per t'u futur ne territorin e kesaj
Pale;
- vendet e perdorura per ruajtjen e mallrave dhe sende-
ve te tjera ne kondita qe justifikojne, ne baza te
shendosha, dyshimin qe ato jane vendosur me qellim
qe te lehtesojne shkeljet doganore.

3. Administratat Doganore, pas kerkeses qe bejne, do te
japin reciprokisht informatat qe disponojne dhe qe kane lidhje me
veprimtari te cilat mund te sjellin shkelje doganore.

4. Informatat qe kane lidhje me rrezikun e shkaktimit te
nje demi te konsiderueshem ne ekonomi, ne shendetin dhe sigurine
publike, ose sektore te tjere te interesit jetik te Pales tjeter,
jipen edhe ne rastin kur per to nuk eshte bere kerkese respek-
tive.

Kjo zbatohet ne veçanti lidhur me trafikun e jashteligjshem
te armeve, narkotikeve, substancave psikotropem prekursoreve dhe
sendeve te rrezikshme, si dhe gjithashtu per objektet me vlera

kulturore

5. Administratat Doganore te Paleve, pas kerkeses qe bejne, japin reciprokisht informatat qe disponojne mbi dokumentt e transportit dhe dergesave te mallrave dhe te sendeve te tjera, referuar vlerave te tyre, vendin nga jane ato dhe vendin e destinacionit te tyre.

NENI 14

Zbatimi i marreveshjes

Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave e Ministrise se Financave dhe Ekonomise se Republikes se Shqiperise dhe Drejtoria e Pergjithshme e Doganave e Ministrise se Financave te Republikes se Greqise mund te hyjne ne lidhje te drejtperdrejta midis tyre per te rregulluar çeshtjet qe kane te bejne me kete Marreveshje dhe ne qofte se eshte e nevojshme, te kene konsultime per rregullimin e çeshtjeve lidhur me zbatimin e saj.

Ato do te bejne gjithashtu çdo perpjekje, ne menyre qe me konsensus reciprok, te rregullojne çeshtjet interpretative qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Marreveshjeje.

NENI 15

Hyrja ne fuqi dhe mbarimi i kohes se zbatimit

Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi gjashtedhjete dite pasi Palet te kene shkembyer nota verbale diplomatike, me te cilat bejne te ditur se procedurat juridike kombetare, te nevojshme per te hyre ne fuqi Marreveshja jane plotesuar.

Kjo Marreveshje nenshkruet per nje periudhe te pacaktuar kohe. Ajo nder te tjera, mund te perfundoje nga te dy Palet me anen e nje note te shkruar nepermjet kanaleve diplomatike dhe pushon se qeni ne fuqi, pasi te kalojne tre muaj nga koha e marrjes e nje note te tille.

U hartua ne Athine sot me daten 17 maj 1993 ne dy ekzemplare origjinale ne gjuhen shqipe dhe greke, duke pasur te dy tekstet te njeten fuqi.

PER QEVERINE
E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PER QEVERINE
E REPUBLIKES SE GREQISE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 331 datë 9.7.1993

PËR

**MIRATIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS [redacted] PËR BASHKËPUNIMIN E ADMINISTRATAVE DOGANORE"**

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për bashkëpunimin e administratave doganore", e cila u nënshkrua në Athinë më 17 maj 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI

Nr.prot.1866/1

Datë 13.7.1993

PRESIDENCËS
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË KASACIONIT
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE [illegible]
MINISTRISË SË PUNËVE TË [illegible]
[illegible]
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME [illegible]

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VULLNET ADEMI

Printo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.331 Date 9.7.1993

PER
MIRATIMIN E "MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE GREQISE PER BASHKEPUNIMIN E ADMINISTRATAVE DOGANORE"

Me propozimin e Minmistrise se Ekonomise dhe Finncave dhe te Ministrise se Puneve te Jashtme, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I ;

Miratimin e "Marreveshjes ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Greqise per bashkepunimin e administratave doganore", e cila u nenshkrua ne Athine me 17 maj 1993.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI